



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Nr: KSC-CC-2019-07

Vendos: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatës Vidar Stensland, Kryetar i panelit
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Antonio Balsamo

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrës parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 10 dhjetor 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Kërkesë e Prokurorisë për autorizim për t'i kthyer përgjigje parashtrimit të
protokolluar KSC-CC-2019-07/F00009**

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësi i Specializuar për z.

Driton Lajçi

Z. Tobi Kadman

1. Më 9 dhjetor 2019, z. Driton Lajçi ('Parashtruesi') dorëzoi një Kundërpërgjigje¹ ndaj Përgjigjes² së Zyrës së Prokurorit të Specializuar ('ZPS').
2. Rregullorja e Punës³ nuk përmban dispozita për parashtrime në formën e 'kundërpërgjigjes' nga ana e parashtruesit, përveç nëse ftohet ta bëjë një gjë të tillë nga paneli i caktuar i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.⁴ Paneli⁵ duhet ose (i) të mos e marrë në shqyrtim kundërpërgjigjen, ose (ii) të autorizojë ZPS-në që t'i kthejë përgjigje asaj.
3. Në qoftë se synimi i panelit nuk është mosshqyrtimi i kundërpërgjigjes, kjo bën të nevojshme që ZPS-ja të autorizohet të kthejë përgjigje për arsye se kundërpërgjigja, *inter alia*: (i) për herë të parë bën parashtrime lidhur me pranueshmërinë, kur parashtruesi nuk e bëri këtë në kërkesën referuese fillestare;⁶ (ii) përpiqet të riformulojë bazën e kërkesës referuese fillestare;⁷ (iii) përmban argumente që janë të pasakta nga ana faktike dhe/ose ligjore;⁸ dhe (iv) shtrembëron parashtrimet e ZPS-së.⁹

Numri i fjalëve në origjinal: 309

/nënshkrim/

Xhek Smith

¹ Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar Gjykatës Kushtetuese, KSC-CC-2019-07/F00009, 9 dhjetor 2019 ('Kundërpërgjigja').

² Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar panelit të Gjykatës Kushtetuese mbi ligjshmërinë e procedurës së marrjes në pyetje, KSC-CC-2019-07/F00008, 2 dhjetor 2019 ('Përgjigja').

³ Rregullorja e Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, KSC-BD-03/Rev1/2017 ('Rregullorja').

⁴ Rregullorja, rregulla 15. *Shih, në veçanti*, rregullën 15(2) (sipas së cilës paneli i Gjykatës Kushtetuese mund të kërkojë informacion plotësues ose të dëgjojë parashtrime shtesë në lidhje me referimin, në qoftë se e gjykon të nevojshme).

⁵ Më 15 nëntor 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara lëshoi një vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për të marrë vendim mbi kërkesën referuese të parashtruesit ('paneli') (Vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Gjykatës Kushtetuese, KSC-CC-2019-07/F00002, 15 nëntor 2019).

⁶ Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para 6-21.

⁷ *Shih, për shembull*, Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para 9, 29-30, 39, 45-46.

⁸ *Shih, për shembull*, Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para 8, 12, 33-34, 39.

⁹ *Shih, për shembull*, Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para 8, 13-15, 17-21, 29, 36, 38, 45-46.

Prokuror i Specializuar

E martë, 10 dhjetor 2019

Në Hagë, Holandë